



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:262585

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05636793

KPPP.nr.1983/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës SH.A., me seli në Prishtinë, kundër debitorit ITS TELEKOM, me seli në Vushtrri, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Aktvendimit Përmbartimor E.nr.347/08 të datës 26.08.2008, të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, jashtë seancës, me datën 29.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit ITS TELEKOM, dhe aktvendimi përmbartimor E.nr.347/08 e datës 26.08.2008, i lejuar nga Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës SH.A., ka caktuar aktvendimin për përmbartim E.nr.347/08 të datës 26.08.2008, duke lejuar përmbartimin në bazë të Aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë II.C.nr.40/2007 të datës 29.03.2007, me të cilin është detyruar debitori që të paguaj shumën prej 8,054.57 € me kamatë prej 3.5% duke filluar nga data 29.01.2007 e deri në pagesën definitive, si dhe shumën prej 80.00 € në emër të shpenzimeve procedurale, në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit, nga xhirollogaria e debitorit në xhirollogarinë e kreditorit, ose me regjistrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit me qëllim të përmbushjes së obligimit të përmbartimit dhe shpenzimeve të përmbartimit.

Debitori me prapësim, e ka kundërshtuar aktvendimin për përmbarrim, duke deklaruar ndër të tjera se kemi të bëjmë me kërkesë të parashkruar në kuptim të nenit 353 të LMD-së. Më tutje ka shtuar se palës debitore nuk i është dërguar aktvendimi për lejimin e përmbarrimit dhe rrjedhimisht të njëjtit i është mohuar e drejta mbi paraqitjen e prapësimit. Ka theksuar se vendimi nuk e ka fuqinë e titullit përmbarrimor, për faktin se borxhi është inekzistent, për shkak se në bazë të Ligjit Nr. 05/L - 043 Për Faljen e Borxheve Publike është përcaktuar se për borxhet ekzistuese deri me datën 31.12.2008 do të përfitoj falje të borxheve, ndëshkimeve, interesit si dhe çdo obligimi tjetër, duke shtuar se kjo dispozitë ka përfshirë edhe borxhin e debitorit të krijuar nga data 09.11.2005 deri më datë 11.01.2007. Gjykatës i ka propozuar që aktvendimin për përmbarrim ta anulojë dhe propozimin ta refuzojë si të pabazë.

Kreditore nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Sipas nenit 22 par.1 të LPP-së, janë përcaktuar dokumentet përmbarruese ndërsa me par.1 nën par. 1.1. të këtij neni, si dokument përmbarrues përcaktohet: *“vendimi përmbarrues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbarruese;”*, ndërsa me nenin 36 par.1 të LPP-së, përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarrim, organit përmbarrues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarrues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarrueshmërisë për përmbarrueshmëri”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat, gjeti se Aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, II.C.nr.40/2007 i datës 29.03.2007 i plotfuqishëm nga data 22.05.2008, në bazë të së cilës është mbështetur propozimi për përmbarrim dhe është lejuar urdhri përmbarrimor

është bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar siç kërkohet me nenin 36 të LPP-së.

Në këtë drejtim, rezulton se propozimi për përmbardim mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri, përmban të meta ngase në propozim nuk janë treguar dokumentet origjinale apo kopje e vërtetuar mbi bazën e të cilëve është iniciuar procedura përmbardimore, ashtu siç përcaktohet edhe me dispozitën nga neni 38, paragrafi 1 të LPP-së: *“Propozimi për përmbardim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbardim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbardimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..”*

Sipas nenit 43, par.4 të LPP-së përcaktohet se: *“...Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbardueshmërisë së nxjerrë nga përmbarduesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbardimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbarduesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbardim nga përmbarduesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”.*

Andaj, nga të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret aktvendimi mbi lejimin e përmbardimit E.nr.347/08 të datës 26.08.2008, është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përmbardim nuk i është bashkëngjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumenteve përmbardimore dhe rrjedhimisht propozimi për përmbardim përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrin.

Meqenëse në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbardim, ndërsa organi përmbardues - përmbarduesi privat, nuk ka vepruar konform nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në rast se propozimi për përmbardim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbardues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”*, gjykata shfuqizoi urdhrin përmbardimor dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1983/23, datë 29.04.2024

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.